

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit Bachelor (4 vjet) në "Shkenca Politike/ Marrëdhënie**

**Ndërkombëtare"**

**Universiteti i New York Tiranë**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**PhD. Dorian Jano**

**PhD. Gentian Elezi**



(Maj/2019)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Bachelor (4 vjet) në "Shkenca Politike/ Marrëdhënie Ndërkombëtare"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	MASh Nr. 5181 prot, datë 20.08.2003 MASR Nr. 2160/1 prot, datë 23.03.2018
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare"
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	256 ECTC
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Po
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Po, Në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, (SUNY-ESC) New York, SHBA)
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Nr.studentëve	38 studentë



## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike/ Marrëdhënie Ndërkombëtare"

Ky program studimi është hapur me Shkresë MASH Nr. 5181 prot, datë 20.08.2003, si program Bachelor me emërtimin "Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare", dhe është akredituar me UMASH nr. 285, datë 10.10.2006 bazuar në relacionit të Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006 "Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e disa diplomave të Universitetit të New Yotk-ut Tiranë (UNYT) me emërtimin Shkenca Politike - Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ky program studimi është riorganizuar nga program Bachelor (Bsc.) në program Master Profesional (Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare), me Shkrese nga MAS me Nr. 6858/2, date 06.05.2011. Programi Master Profesional është akredituar (pozitiv, me rekomandime) me Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013, bazuar në VKA Nr. 508, datë 18.07.2013. Programi është riorganizuar si program Bachelor në "Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare", me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018 bazuar në Vendimet Nr. 26, datë 15.06.2016; Nr. 37, datë 28.07.2017 dhe Nr. 42, datë 23.02.2018 të Senatit Akademik të IAL.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: PhD. Dorian Jano dhe PhD. Gentian Elezi si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 14.05.2019 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Në datë 16.05.2018 Institucioni ktheu përgjigje në formë zyrtare në lidhje me Draft – RVJ, në të cilën shprehet se **nuk ka komentet** në lidhje me të.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

### ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

#### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të pasurohet më shumë kultura e përgjithshme e studentëve nga shumë fusha.
- b) Të zërë më shumë vend në kurrikul diplomacia ekonomike dhe ajo kulturore.
- c) Të dinamizohen më shumë me institucionet ku kryhet internship duke ndërtuar studime me interes të dyanshëm.
- d) Të bëhet kujdes me ata që kryejnë këtë Master Profesional (Bachelor) të gjejnë vendin e punës që lidhet me shkollimin.

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për **rekomandimin e parë**, institucioni në Planin Strategjik (2012-2017; 2018-2022) ka vendosur si objektiv parësor ofrimin e një cikli të plotë të lëndëve të Edukimit të Përgjithshëm. Ky cikël lëndësh të kulturës së Përgjithshme përmban lëndë të formimit bazë dhe ato të formimit të përgjithshëm të disiplinave të ofruara nga departamente dhe programe studimi të tjera. Lëndët bazë, si Anglisht (Kompozim) 1 & 2, Aplikime Kompjuterike, Analizë Ligjërimi dhe Shkrim Akademik i Avancuar, Statistikë, i mundëson studentëve të zhvillojnë komunikimin e avancuar, të menduarit kritik, dhe aftësitë analitike dhe sintetike, kurse grupi i dytë i lëndëve të formimit të përgjithshëm të disiplinave të ndryshme i nje studentët me çështjet kryesore të njerësimin në artet liberale dhe shkencat. Në kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike/ Marrëdhënie Ndërkombëtare përfshihen një numër lëndësh të kulturës së përgjithshme. Krahas lëndëve të mëparshme ekzistuese të Kulturës së Përgjithshme (Histori Botërore, Histori Amerikane, Zhvillim Social dhe Ekonomik, Klasikët e Mendimit Politik), janë shtuar si lëndë të reja të formimit të përgjithshëm bazë Shkrim Akademik i Avancuar, Analizë Ligjërimi, Fotografia, Histori Arti, Makroekonomi, Politika dhe Qeverisja Amerikane, Libra të Rëndësishëm dhe Histori e Miteve. Gjithashtu, studentët e programit të studimit Bachelor në SHK/MN ndjekin rregullisht edhe lëndët Marrëdhënie me Publikun, dhe Hyrje në Komunikim. Rreth 80 përqind e lëndëve që zhvillohen në vitin e parë dhe të dytë, janë detyrimisht lëndë të kulturës së përgjithshme.
- Vlerësojmë se institucioni e ka plotësuar rekomandimin.**
- b) Për **rekomandimin e dytë**, institucioni në përputhje me rekomandimin për më shumë trajtim në kurrikul të diplomacisë ekonomike dhe asaj kulturore e ka konsideruar të mjaftueshme përfshirjen e lëndëve mbi diplomacinë dhe temave të cilat lidhen me çështje të diplomacisë publike (diplomacisë ekonomike ose diplomacisë kulturore) si psh. Histori Diplomatike (viti III), E drejta Ndërkombëtare dhe Diplomacia (viti III), Studim i Politikës së Jashtme (viti IV), Promovimi Demokratik (viti IV), Zhvillime Socio-Ekonomike (viti II). **Vlerësojmë se institucioni e ka plotësuar rekomandimin.**
- c) Për **rekomandimin e tretë**, institucioni ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme përveç marrëveshjeve të mëparshme me institucione publike dhe jo-publike, si dhe me disa kompani private. Studentët e programit të studimit Bachelor në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare kanë kryer praktika në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare (Lëvizja Evropiane në Shqipëri, AIIS, IDM, Instituti i Studimeve Politike, Delegacioni i Komisionit European, World Vision Albania, Save the Children, OTTONomy). Gjatë praktikës studentët kanë kryer studime – punime me interes reciprok për të dy institucionet si psh. organizimin një ekspozite me fotot e disa presidentëve të SHBA për ti ilustruar me lajme portretizimin e presidentëve në fjalë nga shtypi bashkëkohor në Shqipëri, ku u publikua edhe një katalog me produktin final të praktikës (të angazhuar 4 studentë të programit Bachelor në Shkenca

Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare). Gjithashtu, studentët të cilët kanë kryer praktikën mësimore pranë institucioneve publike të tilla si Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ish-Ministria e Integritimit, Bashkia e Tiranës janë përfshirë në sektorë (Drejtoria për Amërikën, ajo për BE-në, për rajonin) që i mundëson studentit aplikimin e njohurive teorike të lëndëve të ndryshme me zbatimin praktik në detyrat funksionale në këto institucione, ndërkohë që studentët të cilët janë përfshirë në OJF të ndryshme, janë përfshirë në shkrim dhe zbatim projektesh duke kontribuar edhe në studime të ndryshme. Institucioni mban domumentacion të raporteve pas përfundimit të praktikës mësimore në Zyrën e Rekordeve, nga shqyrtimi i një raporti evidentojmë se ka elementë studimore në të cilën studenti është i përfshirë gjatë praktikës në institucionin pritës. **Vlerësojmë se institucioni e ka plotësuar rekomandimin.**

- d) Për **rekomandimin e katërt**, institucioni ofron këshillim intensiv karriere për studentët që në momentin e përzgjedhjes së degës dhe më pas me asistimin në gjetjen dhe kryerjen e internshipit apo edhe nëpërmjet panairit të punësimit të organizuar nga Universiteti. Zyra e Karrierës dhe ajo Alumni asiston në mënyrë të vazhdueshme studentët në karrierën e tyre profesionale pasuniversitare. Nga të dhënat e institucionit, rezultun se numri i studentëve të diplomuar në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare për vitet 2013-2018 është 43 nga të cilët 25 janë të punësuar në përputhje me diplomën, rreth 60%, kurse 18 studentë të tjerë janë të punësuar jo në përputhje me diplomën ose janë duke vazhduar studimet master. Të diplomuarit e këtij programi studimi janë punësuar në administratën publike në institucione të tilla si Ministria e Jashtme dhe Europës, Bashkia e Tiranës dhe AKTI, në organizata ndërkombëtare apo OJF të tilla si Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri, GIZ, Save the Children, World Vision, Terre d'Home, IDM. Nisur nga fakti që ky program studimi është program i ciklit të parë dhe një pjesë e mirë e të diplomuarve dshirojnv të vazhdojnë studimet master, por edhe nga të dhënat sasiore (% e numrit të punësuarve në përputhje me diplomën) si dhe institucionet në të cilat janë punësuar të diplomuarit e këtij programi studimi, **vlerësojmë se institucioni e ka plotësuar rekomandimin.**



## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i Universitetit të New York-ut në Tiranë (UNYT) është të përgatisë profesionistët e ardhshëm përmes mësimdhënies, të mësuarit dhe kërkimit duke vënë theksin në zhvillimin personal dhe integrimin në komunitet, si dhe të ofrojë njohuri, aftësi, dhe besim të nevojshëm për të arritur sukses në një mjedis pune të larmishëm dhe ndërkombëtar. UNYT është i angazhuar për zhvillimin intelektual, kreativ dhe personal të studentëve dhe për përgatitjen e studentëve për të qënë qytetarë të aftë të komunitetit botëror. UNYT bashkërendon arsimin liberal me atë të aplikuar dhe të orientuar drejt ekonomisë së tregut duke vënë theksin në zhvillimin e vashdueshme të tij si një institucion kërkimor.

Sipas Planit Strategjik institucional, UNYT angazhohet në ofrimin e një cikli studimi të përgjithshëm të lëndëve të Edukimit të Përgjithshëm për t'u përshtatur kërkesave dhe zhvillimeve të kohës të cilat kanë një pikëprekje socio-politike, ekonomike dhe kulturore dhe kërkojnë një qasje ndërdisiplinore. Objektivat kryesore të Planit Strategjik (2012-2017; 2018-2022) janë ofrimi i një cikël të plotë të lëndëve të edukimit të përgjithshëm, aplikimi i një sërë metodash inovative në mësimdhënie dhe kërkim, adresimi i nevojave individuale të studentëve si individë aktivë dhe krijues, vëzhgimi i kujdesshëm i zhvillimeve në fushën e të Arsimit të Lartë Evropian. Këto objektiva janë detajuar dhe përshtatur në strategjinë e programit BSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e cila synon të pajisur studentët me njohuri, aftësi, dhe eksperiencë në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke ofruar një kurrikul e cila ndërlihd njohuritë teorike me eksperiencën praktike të aplikuara nga aktorë vendas dhe të huaj. Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare ka si objektiva kryesorë aftësimin e studentëve që të kuptojnë mënyrat dhe procesin e analizimit, pasqyrimin dhe argumentimit me të cilat veprojnë faktorët politikë dhe ndërkombëtarë; përfitimn e kompetencave analitike në interpretimin e fenomeneve politike dhe ndërkombëtare nëpërmjet teorisë dhe përdorimit të predispozitave legale e statutore të institucioneve dhe organizmave kombëtare, rajonale dhe globale; si dhe aftësimin e studentit të kontekstualizojë mendimet dhe vendimet në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare duke mbajtur qëndrime analitike dhe sintetike.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e UNYT, për të përgatitur profesionistët e ardhshëm përmes mësimdhënies, të mësuarit dhe kërkimit duke vënë theksin në zhvillimin personal dhe integrimin në komunitet, si dhe duke ofruar njohuri, aftësi, dhe besimin e nevojshëm tek studentët për të arritur suksese në një mjedis pune të larmishëm dhe ndërkombëtar.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	

GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Objektiva e programit BSc në Shkenca Politike /Marrëdhënie Ndërkombëtare synon të pajisur studentët me njohuri, aftësi, dhe eksperiencë në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke ofruar një kurrikul e cila ndërlihd njohuritë teorike me eksperiencën praktike të aplikuara nga aktorë vendas dhe të huaj. Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare ka si objektiva kryesorë aftësimin e studentëve që të kuptojnë mënyrat dhe procesin e analizimit, pasqyrimin dhe argumentimit me të cilat veprojnë faktorët politikë dhe ndërkombëtarë; përfitimin e kompetencave analitike në interpretimin e fenomeneve politike dhe ndërkombëtare nëpërmjet teorisë dhe përdorimit të predispozitave legale e statute të institucioneve dhe organizmave kombëtare, rajonale dhe globale; si dhe aftësimin e studentit të kontekstualizojë mendimet dhe vendimet në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare duke mbajtur qëndrime analitike dhe sintetike.</p> <p>Programi i studimit i është përshtatur kërkesave dhe zhvillimeve të kohës të cilat kanë një pikëprerje socio-politike, ekonomike dhe kulturore dhe kërkojnë një qasje ndërdisiplinore. Programi i studimit bashkërendon arsimin liberal me atë të aplikuar dhe të orientuar drejt ekonomisë së tregut. Ky program studimi krijon kushtet e nevojshme për studentët për të patur sukses në një mjedis pune të ndryshëm, ndërkombëtar si dhe i përgatit ata për jetën si qytetarë të aftë të komunitetit ndërkombëtar.</p> <p>Programi i studimit përgatit studentë të aftë për një rol në të ardhmen dhe pjesëmarrje aktive në një komunitet global dinamik, ku si rezultat i futjes së Shqipërisë në NATO por edhe në Bashkimin Evropian, pashmangshmërisht të rinjtë shqiptarë do të duhet të jenë pjesë e kësaj simbioze.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Objektivat kryesorë të UNYT janë paraqitur në Planin Startegjik (2012-2017; 2018-2022) dhe synojnë ofrimin e një cikeli të plotë të lëndëve të edukimit të përgjithshëm, aplikimin i një sërë metodash inovative në mësimdhënie dhe kërkim, adresimin e nevojave individuale të studentëve si individë aktivë dhe krijues, vëzhgimin i kujdesshëm i zhvillimeve në fushën e të Arsimit të Lartë Evropian. Këto objektiva janë detajuar dhe përshtatur në strategjinë e programit BSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e cila synon të pajisur studentët me njohuri, aftësi, dhe eksperiencë në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke ofruar një kurrikul e cila ndërlihd njohuritë teorike me eksperiencën praktike të aplikuara nga aktorë vendas dhe të huaj.</p> <p>Programi i studimit pajis studentin me njohuri të plota të një kulture të përgjithshme duke ofruar lëndë të formimit bazë (si Anglisht, Analizë Ligjërimit dhe Shkrim Akademik i Avancuar, Statistikë) të cilat i mundësojnë studentëve të zhvillojnë komunikimin e avancuar, të menduarit kritik,</p>

	<p>dhe aftësitë analitike dhe sintetike; si dhe lëndë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjigjshme në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh, duke e aftësuar studentin në të kuptuarit e metodave bazë të kërkimit, si dhe në përcaktimin, vlerësimin, dhe sintetizimin e informacionit dhe të dhënave.</p> <p>Programi i studimit gjithashtu ofron njohuri bazë të aspekteve ndërkombëtare të ekonomisë, shoqërisë, kulturës, komunikimit dhe mediave, të historisë dhe çështjeve bashkëkohore me rëndësi politike dhe ndërkombëtare që i përkasin sigurisë, luftës, paqjes, diplomacies, të drejtës dhe biznesit ndërkombëtar.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit, synon që të plotësojë nevojat dhe pritshmëritë e studentëve të cilët dëshirojnë një shkollim cilësor dhe të bazuar në praktikat më të mira bashkëkohore të vendeve dhe shkollave me përvojë në fushën e arsimit të lartë.</p> <p>UNYT ka një Dokument Strategjik të Politikës së Studimit të Tregut, të zhvilluar në aspekte të ndryshme të cilat lidhen me konkurrencën, ndjeshmërinë ndaj tarifave të shkollimit, kurrikulën si dhe perceptimin e studentëve dhe alumnit. Ky dokument strategjik është miratuar nga Senati në vitin 2018, por akoma nuk ka një plan pune për mënyrën, afatet kohore dhe grupin e punës për realizimin e tij. Mbi bazën e këtij dokumenti, departamenti i Shkencave Shoqërore mund të kryer një studim tregu të përshtatur posaçërisht për programin e studimit. Ky ka qënë edhe një ndër objektivat e planifikimit të departamentit për vitin akademik 2018-2019, sic reflektohet në raportin vlerësues të ecurisë së departamentit 2017-2018.</p>
<b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit, i përgjigjet më së miri proceseve EuroAtlantike dhe demokratizimit të vendit, si interesat madhor kombëtare. Ai përgatit studentë të aftë për proceset demokratike, integruese të vendit në familjen e madhe EuroAtlantike dhe Bashkimin Evropian.</p> <p>Ky program studimi i kushton gjithashtu vëmendje dimensionit kombëtar, proceseve dhe çështjeve kombëtare. Ky program studimi është në përputhje të plotë me vlerat kulturore dhe interesat kombëtare të krijimit të qytetarëve të denjë dhe aktivë në ndryshimet themelore demokratike të shoqërisë si dhe përfaqësimit në arenën ndërkombëtare.</p>



### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare:

1. është konceptuar dhe hartuar në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e UNYT për të përgatitur profesionistë të ardhshëm të aftë për të qënë të suksesshëm në një mjedis pune të larmishëm dhe ndërkombëtar;
2. është në përputhje me objektivat e paraqitur në Planin Startegjik (2012-2017; 2018-2022) të institucionit si dhe strategjinë e programit të studimit;
3. I përshtatet nevojave të tregut dhe të perspektivave ekonomike të vendit duke i kushton vëmendje edhe dimensionit dhe vlerave kombëtare.

Megjithatë, **rekomandojmë** që departamenti, mbi bazë edhe të dokumentit Startegjik të Politikës së Studimit të Tregut të kryejë një studim tregu të përshtatur posaçërisht për programin e studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.

## **2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNTY), është një institucionit privat të arsimit të lartë i licencuar më 15 gusht 2002 në bazë të Vendimit Nr. 397 (15.08.2002) të Këshillit të Ministrave. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.448, datë 11 korrik 2012, UNYT i është miratuar statusi 'Universitet' (VKM Nr. 448 11.07.2012 Për miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë "New York University of Tirana" nga shkollë e lartë universitare në universitet, me emërtimin "Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana)". Aktualisht është i organizuar në tre njësi themelore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, bazuar në udhëzimin e MASH-it nr. 288 22.05.2017.

Fakulteti i Drejtësisë dhe i Shkencave Shoqërore; Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit; dhe Fakulteti i Informatikës. Çdo fakultet përbëhet nga dy departamente dhe një qendër kërkimore. Programi i BSc në Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare ofrohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, i cili është i organizuar në tre njësi themelore: Departamenti i Drejtësisë dhe Disiplinave Humane, Departamenti i Shkencave Shoqërore, dhe Qendra Kërkimore në Shkencat Shoqërore.

Dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore ka gradën shkencore PhD, e cila është në përputhje me neni 25 të Statutit të IAL që përcakton se Dekanët duhet të kenë titullin "Profesor", "Profesor i Asociuar", ose të kenë gradën PhD të fituara në universitetet perëndimore.

Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare ofrohet nga Departamenti i Shkencave Shoqërore. Çdo departament dhe Qendër kërkimore kanë minimalisht nga shtatë anëtarë me kohë të plotë. Përveç anëtarëve me kohë të plotë, Departamenti i Shkencave Shoqërore ka pasur gjithashtu edhe staf akademik me kontratë.

Departamenti propozon drejtimet strategjike dhe rishikimin e kurrikulave si dhe evidenton nevojat për staf akademik.

Përgjegjësi i Departamentit ka gradën PhD, në përputhje edhe me statutin neni 29.

Stafi administrativ përbëhet nga një koordinator për sistemin Bachelor dhe një koordinator i veçantë për programin MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)**

**Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave  
Sociale**

**Departamenti i  
Drejtësisë dhe  
Shkencave Humane**

**Departamenti i  
Shkencave Sociale  
Sciences**

**Qendra Kërkimore e  
Shkencave Sociale  
Science Research  
Center**

Struktura akademike e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore është e përbërë nga tre njësi themelore, nga këto dy departamente dhe një qendër kërkimore, kjo formë organizimi është pozitive pasi fuqizon departamentin si nga ana e procesit mësimdhënës ashtu edhe nga ana e kërkimit shkencor duke krijuar ekuilibër dhe pavarësi midis të dy komponentëve.

Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore:

- Departamenti i Drejtësisë dhe Humanistikës;
- Departamenti i Shkencave Shoqërore; dhe
- Qendra Kërkimore për Shkencat Shoqërore.

Departamenti i Shkencave Shoqërore përveç programit të studimit BSc në Shkenca Politike/ Marrëdhënie Ndërkombëtare ofron edhe programin BSc. në Psikologji, si dhe MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Personeli administrativ është në rank institucioni jo, Fakulteti.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave Shoqërore ka reduktuar numrin e pedagogëve të angazhuar si efektive dhe atë me kontratë, por nga ana tjetër është rritur kualifikimi i anëtarëve të angazhuar të cilët kanë të gjithë grada shkencore dhe tituj akademikë. Aktualisht, departamenti ka të angazhuar 8 anëtarë (50% më pak se në vitin 2016-2017), megjithatë është për tu theksuar fakti se Fakulteti është riorganizuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, duke u shkëputur nga shkencat ekzakte (Në 2016-2017 shkencat kompjuterike kanë qënë pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, Artit dhe Shkencave). Ky ndryshim është cilësor, pasi stafi i angazhuar në departament është më afër profilit të programit si dhe edhe nga fakti që është rritur numri i anëtarëve të cilët kanë tituj akademik.

Për vitin akademik 2018-2019 (7 / 1) nga këta pa grada shkencore PAE (0), PAK (1);

Për vitin akademik 2017-2018 (7 / 3) nga këta pa grada shkencore PAE (0), PAK (0);

Për vitin akademik 2016-2017 (8 / 8) nga këta pa grada shkencore PAE (2), PAK (3);

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Stafi akademik i programit Bachelor në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare përbëhet ekskluzivisht nga pedagogë të cilë kanë minimalisht gradën Ph.D nga universitetet e vendeve të OECD-së.

Mësimdhënia në këtë program studimi është mbuluar kryesisht nga pedagogë të Fakultetit, me përjashtim të vitit akademik 2013-2014, dhe 2017-2018. Numri i pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi është 5-6, përjashtim viti akademik 2017-2018 me 9 (6 PAE dhe 3 PAK).

Numri i pedagogëve me kohë të plotë në departament për lëndët e specializimit Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare është i vogël (5-6), dhe ngarkesa e tyre në programin e studimit Bachelor është e konsiderueshme (pedagogë të cilët japin 6 apo më tepër lëndë të cilat janë me 6 ose 8 ECTS, p.sh përgjegjësi i departamentit ka 8 lëndë në programin e studimit Bachelor në total 58 ECTS ose 23% të ngarkesës totale të programit të studimit Bachelor Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare, pa konsideruar angazhimin në programe të tjera studimi si ai master).

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Në nivel program studimi, Bachelor në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare, personeli akademik mësimdhënës është kryesisht personel akademik efektiv i përbërë prej 5 ose 6 pedagogësh, me përjashtim të vitit akademik 2013-2014 dhe 2017-2018 ku janë angazhuar edhe pedagogë me kontratë, respektivisht 2 dhe 3 pedagogë.

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte **5** pedagogë gjithsej, të gjithë PAE dhe me tituj/grada (1 Prof. dhe 4 PhD).

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **9** pedagogë gjithsej, të gjithë me tituj/grada, nga të cilët **6** kanë qenë PAE (1 Prof. dhe 5 PhD) dhe **3** PAK (2 PhD dhe 1 Dr.).

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **5** pedagogë gjithsej, të gjithë PAE dhe me tituj/grada (1 Prof. dhe 4 PhD).

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **5** pedagogë gjithsej, të gjithë PAE dhe me tituj/grada (1 Prof. dhe 4 PhD).

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **6** pedagogë gjithsej, të gjithë PAE, nga të cilët **5** kanë qenë me tituj/grada (1 Prof., 1 Prof. As., dhe 3 PhD) dhe **1** PhD. Kandidat.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **6** pedagogë gjithsej, të gjithë me tituj/grada, nga të cilët **4** kanë qenë PAE (1 Prof. As. dhe 3 PhD) dhe **2** PAK (2 PhD).

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Në të gjashtë vitet që nga akreditimi i parë vihet re një nivel i lartë akademik i pedagogëve, me grada PhD të fituara jashtë vendit dhe specializim në fushat përkatëse të mësimdhënies. I gjithë personeli akademik mësimdhënës ka tituj dhe grada shkencore, përjashtim një pedagog PhD kandidate.

Aktualisht (2018-2019) ka **1** pedagog me titull shkencor (Prof. As.), dhe **5** pedagogë me gradë shkencore (PHD).

2017-2018 kishte **1** pedagog me titull shkencor (Prof. As.), dhe **7** pedagogë me gradë shkencore (PHD) dhe **1** me gradën Dr.

2016-2017 kishte **1** pedagog me titull shkencor (Prof.), dhe **4** pedagogë me gradë shkencore (PHD).

2015-2016 kishte **1** pedagog me titull shkencor (Prof. As.), dhe **4** pedagogë me gradë shkencore (PHD).

2014-2015 kishte **1** pedagog me titull shkencor (Prof.), **1** pedagog me titull shkencor (Prof. As.), dhe **4** pedagogë me gradë shkencore (PHD) dhe **1** me gradën PhD cand.

2013-2012 kishte **1** pedagog me titull shkencor (Prof. As.), dhe **5** pedagogë me gradë shkencore (PHD).

Të dhënat sipas seksit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 6/0.

Për vitin akademik 2017 – 2018 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 6/3.

Për vitin akademik 2016 – 2017 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 5/0.

Për vitin akademik 2015 – 2016 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 5/0.

Për vitin akademik 2014 – 2015 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 4/2.

Për vitin akademik 2013 – 2014 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 5/1.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Personeli Akademik Efektiv (përfshi asistentët me Msc) përbëhet nga personel i grup moshave të ndryshme: grup mosha 25-35, 5 pedagogë; grup mosha 36-45, 7 pedagogë; grup mosha 46-55, 3 pedagogë; grup mosha 56-65, 1 pedagogë.

Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga personel i grup moshës 25-35, 2 pedagogë.

Personeli Ndihmës Akademik përbëhet nga personel i grup moshave të ndryshme: grup mosha 25-35, 12; grup mosha 36-45, 3; grup mosha 46-55, 5; grup mosha 56-65, 1.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës përgatitet dhe menaxhohet nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kontratat janë të tipologjisë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, ato përcaktojnë në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, pozicionin, ngarkesën e punës dhe objektivat për çdo pedagog, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e institucionit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë  
 Personeli administrativ është në rang institucioni jo departamenti apo fakulteti. Departamenti ka si stafi administrativ një koordinator për sistemin Bachelor dhe një koordinator i veçantë për programin MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Ngarkesa e stafit akademik te programit te studimit.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren e Institucionit (<i>Policy of Faculty Hiring, IR Vacancy Document</i>).</p> <p>Vendet vakante bëhen me njoftim publik në faqet e internetit të institucionit si dhe shtypit ndërkombëtare (Times Higher Education) ose kombëtar sipas nevojave të institucionit. Kandidaturat e interesuara, kalojnë në filtrin e përzgjedhjes dhe verifikimeve të kryera nga Departamenti dhe renditen në listën e përzgjedhjes bazuar në kualifikimet dhe disponueshmërinë e secilit prej kandidatëve. Kandidati i nënshtrohet një interviste (në rastin e kandidatëve ndërkombëtarë intervista kryhet personalisht ose përmes skype). Më pas, Komisioni, i cili në përbërje të tij zakonisht ka Dekanin dhe Rektorin dhe kryesohet nga Kryetari i Departamentit, bën një përzgjedhje përfundimtare dhe njofton sipas rregullit Burimet Njerëzore që të vazhdojnë me përfundimin e kontratës dhe mbledhjen e dokumenteve (Kopjet e diplomave, transkriptet, filozofia e mësimdhënies, kërkimi shkencor i publikuar etj), si dhe leja e qëndrimit për shtetasit e huaj etj.</p> <p>Stafi akademik mësimdhënës në programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare është kryesisht i punësuar me kohë të plotë, përveç vitit 2017-2018 (raporti PAE/PAK 6/9, 67%) dhe vitit 2013-2014 (raporti PAE/PAK 4/2, 67%). Përveç raportit numri i ulët i pedagogë të angazhuar në këtë programi studimi është një pikë e dobët. Numri i pedagogëve me kohë të plotë në departament për lëndët e specializimit shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare është i vogël (5-6), dhe ngarkesa e tyre në programin e studimit Bachelor është e konsiderueshme (pedagogë të cilët japin 6 apo më tepër lëndë të cilat janë me 6 ose 8 ECTS, p.sh përgjegjësi i departamentit ka 8 lëndë në programin e studimit Bachelor në total 58 ECTS ose 23% të ngarkesës totale të programit të studimit Bachelor Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare) pa konsideruar angazhimin në programe të tjera studimi si ai master.</p> <p>Institucioni ndjek procedurat ligjore dhe transparente për vlerësimin e personelit duke përdorur disa instrumenta dhe</p>

	<p>procedura të miratuara paraprakisht dhe përfshijnë vlerësimin e studentëve për secilën lëndë, vlerësimin e kolegëve në baza rotacioni dhe vetë-vlerësimin individual (<i>Staff Assessment Policy Document</i> bazuar në <i>Quality Assurance Document</i>, <i>Peer Evaluation of Teaching</i>, <i>Individual Performance Assessment</i>, <i>Student Evaluation Form</i>)</p>
<p><b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor., ose titullin akademik “Docent,,”</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik të përfshirë në programin e studimit përfshi edhe personit përgjegjës (koordinatorin) për organizimin e programit të studimit. Kjo bazë e të dhënave përfshin CV e plotë të pedagogëve me studimet e kryera, gradat/titujt dhe eksperiencat si dhe dokumentacioni shoqërues i cili disponohet në zyrën e burimeve njerëzore. Të dhënat e pedagogëve janë publike në faqen zyrtare të institucionit <a href="http://unyt.edu.al/index.php/faculty/">http://unyt.edu.al/index.php/faculty/</a></p> <p>Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor-shkencor të angazhuar në këtë program studimi për secilin semestër. Personeli administrativ është në nivel institucioni.</p> <p>Institucioni përcakton kriteret dhe procedurën e rekrutimit bazuar në dokumentin e brendshëm "Policy on Faculty Hiring" të cilat publikon në faqen e internetit të institucionit si dhe në shtypin ndërkombëtar ose kombëtar sipas nevojave të shpalljes.</p> <p>Institucioni ka angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve për programin e studimeve të ciklit të parë BA në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare personel akademik vetëm personel akademik i cili që ka së paku gradën shkencore PhD ose “Doktor., përjashtim bën vetëm një rast në 2014-2015 i angazhimit të një pedagogu PhD kandidate.</p>
<p><b>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Institucioni ka një angazhim jo-optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit Bsc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p> <p>Përlllogaritja e ngarkesës mësimorë e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi është e lartë për disa pedagogë. Nga të dhënat e institucionit, për vitin akademik 2018-2019 disa pedagogë kanë 7 lëndë me ngarkesë 294 orë mësimore, ose 6 lëndë me ngarkesë deri në 280 orë mësimore, përfshi edhe përgjegjësin e departamentit (2 lëndë 8ECTS/56 orë mësimor dhe 4 lëndë 6 ETCS/42 orë mësimore, ngarkesa totale 280 orë mësimore). Kjo <b>ngarkesë mësimore e lartë</b> mund të influencojë negativisht nëse konsiderojmë edhe detyrat e tjera administrative që stafi akademik mbulon si edhe në angazhimin e tyre në punën shkencore kërkimore.</p> <p>Stafi administrativ përbëhet nga një koordinator për sistemin Bachelor dhe një koordinator i veçantë për programin MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare. Për udhëheqjen dhe</p>

	mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për numër studentësh, në raportin 1 instruktor për më pak se 12 studentë, kjo edhe për faktin së në këtë program studimi numri i studentëve është i ulët, përjashtim bën viti akademik 2016-2017 me 13 studentë të regjistruar, ndërkohë në vitet e tjera, numri mesatar i studentëve varion nga 1 në 8 studentë.
<b>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimitor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e stafit në programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe atij mësimitor-shkencor, si vizitat studimore, konferencat dhe projektet kërkimore. Ka një angazhim të stafit në këto komponentë kualifikimi të mëtejshëm megjithatë kjo mbetet në nivel angazhimi individual dhe synimeve dhe prirjeve të vetë stafit.</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu një bazë të dhënash të të gjithë programeve të studimeve të ofruara. Të dhëna rreth programeve të studimit të ofruara janë publike në faqen e internetit të institucionit  <a href="http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/">http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/</a>,  <a href="http://unyt.edu.al/index.php/master-programs/">http://unyt.edu.al/index.php/master-programs/</a>,  <a href="http://unyt.edu.al/index.php/phd-programs/">http://unyt.edu.al/index.php/phd-programs/</a>.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me aktet ligjore në fuqi, statutin dhe rregulloren/politikat e Institucionit të cilat i publikon në faqen e internetit</li> <li>2. Stafi akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit është të paktën 70% të personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit (përjashtim viti 2017-2018 dhe 2013-2014 (raporti PAE/PAK 67%). Megjithatë më shumë se raporti PAE/PAK, problematik është numri i ulët i pedagogëve të angazhuar në këtë program sidomos për lëndët e specialitetit (5 – 6 pedagogë)</li> <li>3. Angazhim jo-optimal i stafit akademik pasi ngarkesa mësimitorë e disa pedagogëve është e lartë 280 - 294 orë mësimore, pa përfshirë angazhimet e tyre në detyrat e tjera administrative dhe punën shkencore kërkimore që stafi akademik mbulon.</li> <li>4. Institucioni ndjek procedurat ligjore dhe transparente për vlerësimin e personelit duke përdorur instrumenta dhe procedura të miratuara paraprkishtë si vlerësimin e studentëve për secilin lëndë, vlerësimin e kolegëve në baza rotacioni dhe vetë-vlerësimin individual, si dhe inkurojon kualifikimin e mëtejshëm të stafit</li> <li>5. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për përgjegjësin dhe anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit, listën e plotë të personelit akademik për secilin semester</li> <li>6. Institucioni angazhon titullarë për lëndët e programit të studimit staf i cili ka së paku gradën shkencore PhD (përjashtim vetëm një rast në një vit akademik), si dhe ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit, përfshi dhe angazhimin e instruktorit për mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale</li> </ol> <p>Megjithatë <b>rekomandojmë</b> që departamentit të konsiderojë angazhimin e pedagogëve me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, e cila do të lehtësojë ngarkesën e madhe të disa pedagogëve si dhe do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së programit</p>	

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Institucioni ofron kushte infrastrukturore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, si në mjedise ashtu edhe në shërbime. Auditorët për ligjërata zënë një sipërfaqje prej 485.9 m<sup>2</sup>, klasat kanë një sipërfaqje prej 133.3m<sup>2</sup>. Mjediset për aktivitete promovuese përbëhet prej 1534 m<sup>2</sup>, laboratorë kompjuteri zënë 175.5 m<sup>2</sup> ndërsa zyra informative për studentët përmban 116 m<sup>2</sup>. Biblioteka ka një sipërfaqje prej 215 m<sup>2</sup>, ndërsa sallat dhe objektet sportive kanë një sipërfaqje prej 663 dhe 648 m<sup>2</sup> secila. Objektet rekreative të dedikuara vetëm për studentët kanë një sipërfaqje prej 1045 m<sup>2</sup> kurse parkimi është 3000 m<sup>2</sup>.

Zyrat në dispozicion të departamenteve dhe qendrave kërkimore kanë 350 m<sup>2</sup> kurse zyra e dekanit ka 75 m<sup>2</sup>. Staf akademik ka një sipërfaqje prej 305 m<sup>2</sup> dhe 133.5 m<sup>2</sup> për sallën e takimeve.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

• Salla për leksione	<b>11 me sipërfaqje 485.9 m<sup>2</sup></b>
• Klasa për seminare	<b>2 me sipërfaqje 133.5 m<sup>2</sup></b>
• Salla për aktivitete promovuese	<b>5 me sipërfaqje 1534 m<sup>2</sup></b>
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	<b>Nuk Ka</b>
• Laboratorë për lëndët	<b>4 me sipërfaqje 175.5 m<sup>2</sup></b>
• Laboratorë informatike	<b>1 me sipërfaqje 97.5 m<sup>2</sup></b>
• Salla interneti	<b>1 me sipërfaqje 215 m<sup>2</sup></b>
• Salla për bibliotekë	<b>3 me sipërfaqje 25 m<sup>2</sup></b>
• Mjedis për fotokopjime, librari etj	<b>2 me sipërfaqje 116 m<sup>2</sup></b>
• Zyrë informacioni për studentët	<b>7 me sipërfaqje 663 m<sup>2</sup></b>
• Mjedise sportive	<b>2 me sipërfaqje 88.5 m<sup>2</sup></b>
• Mjedise shërbimi për të tretë	<b>2 me sipërfaqje 1015 m<sup>2</sup></b>
• Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	<b>20 me sipërfaqje 134.5 m<sup>2</sup></b>
• Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	<b>4 me sipërfaqje 3000 m<sup>2</sup></b>
• Norma m <sup>2</sup> /për student <b>2,5 m<sup>2</sup></b> për student në shkencat natyrore, shkenca shoqërore dhe shkencat humane	

- Mjediset për stafin:

• Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	<b>5 me sipërfaqje 75 m<sup>2</sup></b>
• Zyra për sekretarinë mësimore	<b>2 me sipërfaqje 46 m<sup>2</sup></b>



- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore **5 me sipërfaqje 350 m<sup>2</sup>**
- Zyra për personelin akademik **8 me sipërfaqje 305 m<sup>2</sup>**
- Zyrë për financën **2 me sipërfaqje 44 m<sup>2</sup>**
- Zyrë për Njësinë e SBC **1 me sipërfaqje 6 m<sup>2</sup>**
- Salla për mbledhje **2 me sipërfaqje 133.5 m<sup>2</sup>**
- Mjedis për stafin e shërbimit **5 me sipërfaqje 93.3 m<sup>2</sup>**
- Nyje hidrosanitare për personelin akademik **24 me sipërfaqje 152.5 m<sup>2</sup>**
- Norma m<sup>2</sup>/për person **6 m<sup>2</sup> / staf akademik**

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion një bibliotekë me tekste dhe literaturë bashkëkohore dhe cilësore. Shumica e teksteve të detyrueshme për programin e studimit gjendeshin në bibliotekë ose mund të aksesoheshin virtualisht nëpërmjet sistemit online në bibliotekat me të cilat institucioni ka marrëveshje. Biblioteka, përveç teksteve bazë kishte gjithashtu edhe tekste të tjera në funksion të lëndëve të ndryshme apo për realizimin me sukses të detyrave të kursit dhe projektit të kërkimit.</p> <p>Institucioni ka akses të drejtpërdrejtë në bibliotekën elektronike të universitetit partner American University SUNY Empire State College (Ebrary), e cila përmban libra dhe revista shkencore të mjaftueshme për realizimin me sukses të programit studimor. Gjithashtu, institucioni ka akses edhe në bazat e të dhënave të bibliotekave online si JSTOR, QUESTIA, EBSCO. Së fundmi institucioni ka lidhur marrëveshje dhe ka akses të drejtpërdrejtë në bibliotekën elektronike të librave të McGraw Hill.</p> <p>Përgjegjësi i programit harton një plan të detajuar me titujt që nevojiten si dhe fondin e nevojshëm për të rritur tekstet apo artikujt e nevojshëm në mbështetje të realizimit të programit të studimit, të projekteve të kërkimit shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët. Biblioteka dispononte të paktën 4-5 libra për secilën nga lëndët e programit.</p> <p>orët e shërbimit të Bibliotekës ishin në përputhje me orarin e programeve të studimit dhe nevojat e studentëve duke I ofruar atyre mundësinë e përdorimit të saj si para dhe pas periudhës së leksioneve.</p>
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një numër të mjaftueshëm auditorësh, klasash, zyrash të cilat janë të pajisura me pajisje elektronike dhe mjete të teknologjisë së informacionit për të zhvilluar me sukses programin e studimit si dhe lehtësuar procesin mësimdhënës.</p> <p>Institucioni ka një laborator informatike dhe një salla interneti të pajisur me programet bazë të Teknologjisë së informacionit si dhe programe të ndryshme në funksion të përgatitjes së një prezantimi, për kryerjen e analizave statistikore dhe mjete të tjera teknologjike të cilat mirëmbahen dhe përmirësohen vazhdimisht.</p> <p>Për zhvillimin e praktikave institucioni disponon marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere të cilat kanë mjedisin, hapësirën e nevojshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>
<p><b><u>Konkluzione të GVJ:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni siguron të gjitha ambientet e nevojshme dhe mjetet teknologjike për zhvillimin e programit të studimit.</li> <li>2. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme, bashkëkohore, si dhe akse në bibliotekat elektronike të institucioneve partnere (American University SUNY Empire State College - Ebrary, McGraw Hill) apo databazat e revistave shkencore si JSTOR, QUESTIA, EBSCO.</li> <li>3. Institucioni ka laborator informatike dhe sallë interneti të pajisur me programe teknologjike</li> <li>4. Praktikat profesionale zhvillohen në mjediset e institucioneve partnere me të cilat është lidhur marrëveshje.</li> </ol>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimi kryesor i financimit është tarifa për dhe gjatë shkollimit në masën 99-100% për vitet 2012-2014, dhe 94-95% në vitet 2015-2017. Një kontribut tjetër i burimeve financiare lidhet me grantet për kërkim dhe kontratat të cilat nga 1% në vitin 2012 kanë ardhur në rritje deri në 5% të të ardhurave në 2017. Burim tjetër të ardhurash të pa konsiderueshme minimale vjen nga aktivitetet tregtare si kafe-bar. Burimet financiare të IAL-së nga tarifat e shkollimit kanë pësuar një rënie prej 20% krahasuar me të ardhurat e 6 viteve më parë. Rreth 1/2 e burimeve të të ardhurave shpenzohet për shpenzime të ndryshme dhe po aq për paga, një pjesë tjetër e vogël e burimeve të të ardhurave shkojnë për investime nga 1%-3%, përjashtim viti 2017 me 10%. IAL-ja ka një Zyrë Financiare me dy ekspertë e cila zbaton politikën financiare institucionale.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Më poshtë pasqyrojmë ndarjen në % për vitin 2012 dhe 2017:

• Grantet për kërkim	1% (2012) / 5% (2017)
• Konsulencat, shërbimet	0%
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	99% (2012) / 94% (2017)
• Sponsorizimet	0%
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0%
• Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	0%
• Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	0% (2012) / 1% (2017)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Raporti i shpenzimeve kundrejt pagave dhe investimeve përgjatë viteve varian nga 41% (2017) në 53% (2012), në po të njëjta shifra variojnë edhe pagat, kurse investimet mbeten në nivele të ulëta 1%-4%, me përjashtim të vitit 2015 ku investimet zënë rreth 10%. Kostoja për një student në këtë program studimi përlllogaritet në vlerën **3053 euro për vitin akademik 2013-2014 dhe 3442 euro për vitin akademik 2017-2018**, duke konsideruar shpenzimet për pagat, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, dhe kosto të tjera të departamentit.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b> <b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	Institucioni kryen audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar billancit për të ardhurat dhe shpenzimet e programeve të studimit. Institucioni ka kryer edhe audit të jashtëm për vitin financiar 2017.
<b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	
<b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Në 6 vjecarin e fundit, IAL-ja ka përfituar nga grante të huaj apo kontrata shërbimesh në shumë rreth 5% të të ardhurave. Për disa nga këto programe grande janë kryer edhe raporte audit të jashtëm si psh projekti i kërkimit granti RRPP 2014-2015.
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b> <b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;	Zyrë Financiare e institucionit harton raporte financiare të hollësishme për ti përdorur strategjikisht në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e programit dhe koston, si dhe për të siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë. Institucioni dokumenton jo vetëm për tre vitet e kaluara, por edhe më herët. UNYT mban aplikimin e praktikave kontabël në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat janë të deklaruara qartë dhe të dobishme për Bordin e Administrimit dhe personelin drejtues; Monitorimin e
<b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;	

<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>buxhetit në baza aktuale dhe/ose krahasuese për të kuptuar më mirë financat e tyre; përgatitjen e parashikimeve të rrjedhës së parasë dhe parashikimin e të ardhurave të fundvitit, shpenzimet dhe kostot e studentëve për të ndihmuar në marrjen e vendimeve të drejta të menaxhimit gjatë vitit.</p> <p>Burimi kryesor i financimit është tarifa për dhe gjatë shkollimit në masën 99-100% për vitet 2012-2014, dhe 94-95% në vitet 2015-2017. Një kontribut tjetër i burimeve financiare lidhet me grantet për kërkim dhe kontratat të cilat nga 1% në vitin 2012 kanë ardhur në rritje deri në 5% të të ardhurave në 2017. Burim tjetër të ardhurash të pa konsiderueshme minimale vjen nga aktivitetet tregtare si kafe-bar. Burimet financiare të IAL-së nga tarifat e shkollimit kanë pësuar një rrënie prej 20% krahasuar me të ardhurat e 6 viteve më parë, dhe po të konsiderojmë që IAL financohet kryesisht nga tarifa e studimit mund të reflektojë ndaj qëndrueshmërisë financiare. Ndërkohë është rritur kontributi nga grantet, kjo si një burim alternativ.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni mban raporte financiare të të ardhurave dhe kostove, si dhe kryen audit të brendshëm të përvitshëm si dhe audit të jashtëm</li> <li>2. Programi i studimit financohet 95% nga tarifat e shkollimit, të ardhura të cilat kanë pësuar 20% rrënie në 6 vitet e fundit.</li> <li>3. Institucioni ka në rritje shtimin e të ardhurave nga grande dhe fonde të ndryshme, të cilat janë burime alternative dhe mund të ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.</li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar si strukturë organizative në Statutin e UNYT, përmes Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KGSC) i cili zgjidhet nga Senati Akademik dhe siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë përmendet edhe në Planin strategjik të UNYT, 2018-2022, si dhe ka një Manual për Sigurimin e Cilësisë.

KGSC përbëhet nga kryetarja dhe 5 antarë, përfaqesues nga të gjitha fakultetet dhe nga studentët. KGSC është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njëjësive akademike dhe mbështetëse të studentëve që garantojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar duke siguruar një përmirësim të cilësisë së vazhdueshëm në UNYT në bashkëpunim me të gjithë partnerët e saj institucionale.

UNYT gjithashtu ka qënë partner në projektin Erasmus+: QainAL “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm
- Etj

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC kryen vlerësimin e personelit akademik nga ana e studentëve, në mënyre periodike (semestrare). Ky process koordinohet nga Asistentja e Rektorit në bashkëpunim me Koordinatorin e zyrës së sigurimit të cilësisë. Përgjigjet llogariten dhe rezultatet ndahen me Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, dekanin e fakultetit dhe Rektoratin, duke ruajtur diskrecion për të shmangur konfliktin e interesit. Rezultatet e vlerësimit depozitohen në Zyrën e Regjistrave ku dhe ruhen, ato përbëjnë bazën e analizës departamentale të performancës dhe sigurimit të cilësisë. Departamenti zgjedh në mënyrë rastësore klasa dhe raportojnë mbi gjetjet e tyre përsa i përket Drejtësisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit. Ky proces zhvillohet periodikisht, një herë në semestër, dhe gjatë 3-4 javëve të para të një semestri pasues.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësoni Tabelën 4, Aneksi 4)

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Koordinatori i Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve, Drejtorët e Departamentit që mbulojnë Programin janë përgjegjës për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.

Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit është një mënyrë për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe të mësuarit në nivel departamenti. Ky raport përgatitet nga Shefi i Departamentit në lidhje me komponentën e mësimdhënies dhe të mësuarit dhe nga Drejtori i Qendrës Kërkimore në lidhje me cilësinë e prodhimit hulumtue.

Shefi i Departamentit përgatit Raportin Vjetor të Departamentit në bazë të raporteve të Drejtorit të Programit, formularëve të vetëvlerësimit, të cilat përfshijnë kërkimin shkencor, aplikimin për fonde të brendshme / të jashtme, ngarkesën e mësimdhënies si dhe shërbimet për institucionin.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Të gjitha vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e procedurave të vlerësimit përpunohen dhe depozitohen në Zyrën e Regjistrimit, dhe ato pasqyrohen në Raportin vjetor të Departamentit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i dorëzohen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Senatit nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara. Procedurat e Sigurimit të Cilësisë rishikohen në periudha të rregullta me qëllim përmirësimin e tyre.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Institucioni përdor procedura standarte të vlerësimit të ecurisë së programit të studimit, të cilat përbëhen nga vlerësimet e studentëve për pedagogë si dhe për lëndën, vlerësimet e kolegëve për njëri tjetrin, formën e vlerësimit të performancës individual të profesorëve, si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien, të nxëniet dhe standardet përkatëse të cilësisë të përpiluara nga secili Departament në fund të vitit akademik.</p> <p>UNYT përdor instrumente të drejtpërdrejta dhe indirekte, me studentë, të diplomuar, alumni, staf akademik dhe administrativ.</p> <p>Vlerësimet e studentëve trajtohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet bëhen publike tek pedagogët përkatës sapo lënda të ketë përfunduar. Shefi i Departamentit si dhe Dekani përkatës janë të informuar në detaje në lidhje me rezultatet e procesit si dhe kanë mundësi për të propozuar përmirësime, kur është e nevojshme.</p> <p>Raporti Vjetor Institucional miratohet nga Senati dhe pastaj është publik për të gjithë aktorët. Bazuar në të, dokumenti i performancës përpilohet dhe është i hapur për të gjithë stafin dhe studentët.</p> <p>Politikat e procedurat për sigurimin e cilësisë janë të shpallura në Manualin për Sigurimin e Cilësisë, Statutin e UNYT, në bulletinin e studenteve edhe në raporte zyrtare të profilit institucional të UNYT drejtuar universiteteve partnerë.</p>
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe</p>	<p>UNYT është akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë me anë të dekretit No. 385 më 10 Dhjetor, 2006 [Prot. No.: 7034/10.10.2006], dhe ri-akreditimi institucional u konfirmua me Urdhëresë nr. 405 (28.10.2015). Me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 102, datë 10.11.2017, institucioni u vlerësua se ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar</p>

<p>standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>(QAA).</p> <p>UNYT përdor instrumentet e duhur për sigurimin e cilësisë, ku përfshihen vlerësimet e studentëve, (për pedagogët), raportet e vetëvlerësimit, vlerësimi i pedagogëve nga supervisorët për secilin pedagog.</p> <p>UNYT për të siguruar cilësinë e çdo programi studimor në përputhje me standardet bazohet në Statutin, Planin Strategjik, Manualin e Sigurimit të Sigurisë. Manuali i Sigurimit të Cilësisë është instrumentet institucional i cili është dokumenti bazë për Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit. Manuali i Sigurimit të Sigurisë siguron të gjitha procedurat dhe informatat / modelet e formularëve të vlerësimit të aplikuara në nivel institucional siç janë; Formulari i Performancës së Vlerësimit Individual, Raporti i Paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimit, Formulari i vlerësimit të studentëve, Raporti Vjetor i Departamentit, Formularë të vlerësimeve të kolegëve, Formulari i Vetë-Vlerësimit etj. Procedurat e procesit të sigurimit të cilësisë mbikëqyren nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit.</p> <p>Për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve studimore, UNYT përdor mekanizmat formalë sic janë rishikimi i planit mësimor nga kreu i departamenteve dhe dekanëve për semestër, dhe në bazë të zhvillimeve të institucionit, kërkesave ligjore dhe nevojave të tregut ekziston një rishikim periodik i kurrikulës i cili miratohet nga Senati.</p> <p>Studentët në të gjitha nivelet e vendimmarrjes kanë përfaqësuesit e tyre, në Senat, Këshillat e Fakultetit, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit etj.</p> <p>Si studentët dhe stafi janë të informuar mbi procesin e vlerësimit të brendshëm, si dhe procedurat e përfshirjes dhe rezultatet e vlerësimeve të ndryshme.</p> <p>Të gjitha procedurat, dhe politikat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë janë të miratuara dhe të publikuara.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. UNYT është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 102, datë 10.11.2017</li> <li>2. UNYT ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe një politikë të sigurimit të cilësisë që bazohet në Statutin, Planin Strategjik, Manualin e Sigurimit të Sigurisë dhe përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, si dhe vlerësimet e studentëve për pedagogë si dhe për lëndën, vlerësimet e kolegëve për njëri tjetrin, formën e vlerësimit të performancës individual të profesorëve, si dhe vlerësimin në raportet vjetore të departamenteve.</li> </ol>	

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare synon të pajisë studentët me njohuri, aftësi, dhe eksperiencë, që i ndihmojnë të diplomuarve të këtij programi të hyjnë me sukses në tregun e punës ose për të vazhduar studime të mëtejshme pasuniversitare. Kurrikula dhe modulet e tij janë hartuar mbështetur në eksperiencën akademike dhe profesionale të stafit akademik brenda dhe jashtë UNYT, si edhe në përvojat e të diplomuarve. Programi i studimit u siguron studentëve mundësinë të bëhen pjesë e një kurrikule që kombinon teorinë dhe praktikën e çështjeve politike të brendshme e ndërkombëtare. Programi i studimit i ofron studentëve të fitojnë njohuri të nevojshme në mjedisin ndërkombëtar bashkëkohor, si dhe t'i aftësojë ata për të mbajtur qëndrime analitike dhe sintetike duke i ndërthurur me eksperiencën praktike.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit është licencuar me Shkresë MASH Nr. 5181 prot, datë 20.08.2003, dhe është akredituar me UMASH nr. 285, datë 10.10.2006 bazuar në relacionin e Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006. Ky program studimi është riorganizuar nga Bachelor në Master Profesional, me Shkresë të MAS Nr. 6858/2, datë 06.05.2011. Programi është akredituar me Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013, bazuar në VKA Nr. 508, datë 18.07.2013 (Pozitiv, me rekomandime). Programi është riorganizuar si program Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018 bazuar në Vendimet Nr. 26, datë 15.06.2016; Nr. 37, datë 28.07.2017 dhe Nr. 42, datë 23.02.2018 të Senatit Akademik të UNYT.

Programi i studimit u zhvillua në kontekstin e globalizimit dhe demokratizimit, për të plotësuar nevojat e bashkësisë ndërkombëtare, profesionistëve në marrëdhënie pune dhe studentëve. Qëllimi i tij është tu afrojë studentëve të kuptojnë teorinë dhe praktikën e sistemit politik si dhe marrëdhënieve ndërkombëtar.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Plani mësimor (256 ECTS 2018-2019) i këtij programi është ndarë në 8 semestra respektivisht 30 ECTS për 4 semestrat e parë, 36 ECTS për semestrin 5 dhe 6, 32 ECTS për semestrin e 7 dhe të 8-të. Ngarkesa mësimore e çdo lëndë është shprehur në numër orësh mësimore dhe vlerën respektive në ECTS, në vitin e parë dhe të dytë, çdo semestër ka 5 lëndë me 6 ECTS secila; në vitin e tretë çdo semestër ka 6 lëndë me 6 ECTS secila; kurse viti i katërt ka 4 lëndë me 6 ECTS secila. Orët mësimore janë të organizuara në leksione



- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Megjithatë nga ana e paraqitjes formale, prezantimi i syllabuseve nuk ka një format të standartizuar dhe përmbajtja ndryshon, në disa syllabuse gjen shpjegime të detajuar të lëndës në disa të tjera informacioni është i pa mjaftueshëm.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Tematikat e lëndëve janë të mirë organizuara me një rrjedhje logjike midis tyre, në funksion të mbulimit sa më të madhë të koncepteve bazë, qasjeve teorike, dhe sjelljes së rasteve empirike të studimit. Gjithashtu, një pjesë e mirë e syllabuseve kanë një qasje ndërdisiplinore në çështjet që ato mbulojnë.

Syllabuset e lëndëve janë të fokusuar në kompetencat që studentet do të përfitojnë. Ato përshkruajnë lëndën dhe tematika që trajtohen si dhe literaturën bazë dhe të rekomanduar. Literatura është përgjithësisht bashkëkohore por ka hapësirë për përmirësim nga pikëpamja e përditësimit, pasi në disa lëndë vërejmë që syllabusi nuk është i përditësuar

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Bsc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare është licencuar me Shkresë MASH Nr. 5181 prot, datë 20.08.2003, dhe është akredituar me UMASH nr. 285, datë 10.10.2006 bazuar në relacionin e Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006. Ky program studimi është riorganizuar nga Bachelor në Master Profesional, me Shkresë të MAS Nr. 6858/2, datë 06.05.2011. Programi është akredituar me Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013, bazuar në VKA Nr. 508, datë 18.07.2013 (Pozitiv, me rekomandime). Programi është riorganizuar si program Bachelor, me 256 ECTC, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018 bazuar në Vendimet Nr. 26, datë 15.06.2016; Nr. 37, datë 28.07.2017 dhe Nr. 42, datë 23.02.2018 të Senatit Akademik të UNYT.</p> <p>Programi i studimit është organizuar në module dhe vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Kreditimit dhe Transferimit (ECTS). Shuma mesatare</p>

	e kreditëve që një student me kohë të plotë akumulon në një vit akademik zakonisht është 60 kredite, për vitin I dhe të II, 72 ECTS në vitin e tretë dhe 64 ECTS në vitin e katërt. Studentët të cilët përfundojnë me sukses të gjitha detyrimet përfshirë edhe marrjen e 32 krediteve për kurset e Empire College - State University of New York, të cilat i kryejnë në kampusin e UNYT, dhe edukimin në distance në fakultetet e Empire State College marrin diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me State University of New York.
--	--

**II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**  
**Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.**

<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit BSc në Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare, është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Dekanati i këtij Fakulteti ofron informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e këtij programi studimi, duke përfshirë lëndët e detyrueshme të formimit të përgjithshëm dhe ato të specialitetit, si dhe grup lëndët me zgjedhje.</p> <p>Gjithashu njësia kryesore ofron informacionin e nevojshëm edhe në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin etj. Mbledhja e syllabuseve bëhet nga njësia bazë sipas detajimit dhe informacionit të përcjellë nga njësia kryesore në lidhje me pjesën përmbajtësore por edhe strukturore të syllabuseve të cilat ruhen në mënyrë konsistente si rekorde nga sekretariati. Informacioni i detajuar në lidhje me programin e studimit, syllabuset, kreditet (të shprehura në kreditë të sistemit Amerikan) dhe informacione të tjera të rëndësishme janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit: <a href="http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/political-sciences-international-relations/">http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/political-sciences-international-relations/</a></p>
---	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Programi i studimit BSc në Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare, është program i akredituar, i organizuar në module dhe i vlerësuar me kredite (sipas sistemi Amerikan të crediteve të konvertuara edhe sipas Sistemit Evropian të Kreditimit dhe Transferimit ECTS).
2. Shuma mesatare e kreditëve që një student akumulon në një vit akademik është 60 kredite për vitet e para, dhe vitin e tretë dhe të katërt 72 dhe 64 ECTS respektivisht.
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, përgjegjës për programin e studimit, ofron informacionin e nevojshëm për përmbajtjen, lëndët e detyrueshme të formimit të përgjithshëm, të specialitetit dhe ato me zgjedhje, ngarkesën mësimore në auditor, frekuentimin dhe informacione të tjera për programin e studimit, të cilat janë në faqen e webit të UNYT

Megjithatë **rekomandojmë** që departamenti të rishikojë shpërndarjen e lëndëve të planit mësimor sipas veprimtarive formuese sipas akteve nënligjore dhe duke ndjekur një logjikë më të qartë të ndarjes së lëndëve në kategorinë respektive, si dhe të standartizojë paraqitjen formale të prezantimit të syllabuseve dhe përditësimin e tyre.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia organizohet në formë klase, kombinim i leksioneve dhe seminareve në një sistem të ngjashëm me atë amerikan pa i ndarë leksionet nga seminarët në orë më vehte. Kjo metodë e mësimdhënies ka në qëndër studentin dhe kombinon ligjëratat me pyetje të shpeshta si dhe shembuj empirikë apo raste studimi. Teknologjitë e mësimdhënies përfshijnë përdorimin multimedial, prezantimet me PowerPoint dhe forma të tjera relevante që ndihmojnë procesin mësimor. Studentët angazhohen në mënyrë të vazhdueshme duke organizuar modele të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, organizimin e gjyqeve stimuluese, kërkime në site të caktuara, si dhe duke ju dhënë listën e leximeve të rekomanduara për tu përgatitur që të diskutohen më tej në klasë. Numri i vogël i studentëve favorizon diskutimin dhe individualitetin e studentit. Kontrolli i njohurive përcaktohen në syllabusin e çdo lënde dhe bëhet përmes pjesëmarrjes dhe aktivizimit në orën e mësimi, detyrave dhe eseve, projekteve në grup si dhe provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar.

*Inkurajohet që departamenti të organizojë më tepër aktivitete ekstrakurrikulare në funksion të programit të studimit, duke nxitur dhe dhënë rëndësi edhe aktiviteteve jashtë formatit klasik të organizimit të mësimin në auditor, si p.sh organizimin e vizitave studimore në institucione të ndryshme apo organizimi i auditoreve të hapura me të ftuar personalitete apo ekspertë të fushave të ndryshme.*

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Orët në auditor integrojnë leksionet dhe seminarët sipas modelit amerikan

- Leksione dhe Seminare      **1556 orë në auditor**
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi atyre të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Studenti vlerësohet përmes ndjekjes së lëndës dhe pjesëmarrjes aktive (20%), shkrimit të esesë (15%) prezantimeve (15%) dhe provimit përfundimtar (50%). ***Megjithatë pavarësisht këtij rregulli të përgjithshëm, komponentët e vlerësimit dhe përqindja respektive është në diskrecionin e pedagogut të lëndës dhe e shprehur në mënyrë eksplicite në çdo syllabus.***

Institucioni ka një kontratë me Web-faqen primare anti-plagjiaturë TURNITIN-in, e cila mundëson kontrollin për nivelin e origjinalitetit të detyrave dhe punimeve të studentëve, para se të vlerësohen për përmbajtje substanciale dhe akademike.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

2 studentë janë angazhuar në punime shkencore individuale të pedagogëve, 7 studentë janë angazhuar në projekte në rang departamenti dhe 11 në rang fakulteti, si dhe 2 studentë janë angazhuar në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë. Këtë vit akademik UNYT planifikon të organizojë një konferencë studentore, e cila është një praktikë e mirë për përfshirjen e studentëve të departamentit në kërkimin shkencor.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për pranimin e studentëve në programin e studimit Bsc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare studenti duhet të ketë diplomë dhe listë notash të shkollës së mesme, CV, dhe kopje të testeve të mbrojtura të gjuhës angleze. Komisioni i pranimeve zgjidhet çdo vit dhe përbëhet nga anëtarë të departamente të ndryshme, të cilët analizojnë dosjet e secilit kandidat, notën mesatare, nivelin e gjuhës angleze dhe dokumenta të tjerë mbështetës. Në përzgjedhjen e studentëve komisioni i pranimeve, merret parasysh notën mesatare të shkollës së mesme së bashku me rezultatet e maturës, në bazë të së cilave bëhet rënditja e studentët të ardhshëm sipas sistemit preferencial.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

#### Procedurat e pranimit të studentëve

Zyra e pranimeve është përgjegjëse për të ndjekur procedurat e pranimit të studentëve. Detyrat e zyrës dhe procedura e pranimit janë të mirëpërcaktuara dhe miratuara nga administratori, ato përfshijnë, që nga kontaktet fillestare me të interesuarit, aplikimin për regjistrim, zhvillimin e provimeve për bursat dhe testin e gjuhës angleze.

Studentët e interesuar në programin e BSc-së në Shkenca Politike / Marrëdhënieve Ndërkombëtare në UNYT, duhet të paraqesin pranë Komisionit të pranimeve dokumentat e më poshtëm:

- Diplomën dhe notat e shkollës së mesme,
- CV,
- 4 fotografi dhe një kopje të letërnjoftimit.
- nivelin B1 / B2 në testet e gjuhës angleze të njohura ndërkombëtarisht (APTIS, TOEFL, dhe IELTS)

#### Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje e studentëve për këtë program studimi është në nivele të mira nëse konsiderojmë notën mesatare hyrëse, e cila është mbi 8 dhe nuk ka patur rënie. Për vitin akademik 2014-2015 nota mesatare hyrëse ka qënë më e larta 8.5

#### Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare:

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në këtë program studimi është 65, rreth 12 studentë në vit, viti 2014-2015 dhe viti 2017-2018 ka patur rënie me 6-7 studentë të regjistruar pvr herë të parë.

Numri i studentëve ndër vite;

**Për vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar 12 studentë nota mesatare hyrëse 8**

**Për vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar 7 studentë nota mesatare hyrëse 8.5**

**Për vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar 16 studentë nota mesatare hyrëse 8.2**

**Për vitin akademik 2016-2017 janë regjistruar 12 studentë nota mesatare hyrëse 8.1**

**Për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 6 studentë nota mesatare hyrëse 8.1**

**Për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar 12 studentë nota mesatare hyrëse 8**

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Mobiliteti i studentëve mbetet i limituar (1-4), megjithatë i konsiderueshëm krahasuar me numrin total të studentëve, edhe për shkak ndryshimesh kurrikulare dhe zhvillimit të lëndëve në gjuhën angleze.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Në total, përgjatë periudhës 2013-2018 janë diplomuar 43 studentë të cilët janë të gjithë të punësuar (100%), 25 (58%) prej tyre janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 18 (42%) janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

**Numri total të diplomuarve**

Në total, përgjatë periudhës 2013-2018 janë diplomuar **43 studentë**

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

**25 studentë**

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

**18 studentë**

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.	Pranimi në programin e studimit Bsc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare bëhet në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Studentët plotësojnë kriteret e pranushemërisë të përcaktuara nga Institucioni, përfshi edhe kriterin e gjuhës angleze. Studentët e këtij programi studimor mbrojnë provimin e gjuhës angleze bazuar në testet e pranuar ndërkombëtarisht, si TOEFL, IELTS dhe APTIS. Me vendim të Senatit Nr. 43, datë 30.03.2018 të interesuarit për tu regjistruar në programin e

	studimit duhet të plotësojnë 2 kriteret shtesë: Kriteri i njohjes së gjuhës angleze niveli B1 (i certifikuar ndërkombëtarisht, dhe kriteri i dytë nota mesatare mbi 6.5.
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikën e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion rreth programit të studimit, organizimit dhe kohëzgjatjes, akreditimit e institucionit dhe të programit të studimit të ofruara, si dhe njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës brenda dhe jashtë vendit, që në momentin e regjistrimit.</p> <p>Studentët vlerësojnë pedagogun në përfundim të çdo lënde.</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbim për këshillim të karrierës për ti ndihmuar ata të integrohen me lehtësi në tregun e punës.</p> <p>Studentëve u jepet informacion rreth mundësive për punësim pas përfundimit të programit të studimit si dhe gjatë praktikës apo aktiviteteve të tjera në bashkëpunim me institucione të ndryshme.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni mban statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programin e studimit Bsc Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.</p> <p>Institucioni mban statistika vjetore edhe për numrin e studentëve të regjistruar atyre të transferuar, të dorëhequr, të larguar apo që nuk e kanë kryer me sukses vitin akademik.</p> <p>Institucioni ka të dhëna për performancën akademike të studentëve nga pranimi deri në diplomimin e tij.</p>
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Institucioni ofron këshillim karriere për studentët që në momentin e përzgjedhjes së degës dhe më pas me asistimin në gjetjen dhe kryerjen e internshit apo edhe nëpërmjet panairit të punësimit të organizuar nga Universiteti. Zyra e Karrierës dhe ajo Alumni asiston në mënyrë të vazhdueshme studentët në karrierën e tyre profesionale pasuniversitare.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe pedagogu i cili drejton lëndën e praktikës, i ndihmon studentët të zgjedhin institucionin në të cilin do të kryejnë praktikën profesionale</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studentët e regjistruar në programin e studimit Bsc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare plotësojnë kriteret e ligjit dhe kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve. Studentët e këtij programi studimor kanë të mbrojtur gjithashtu gjuhën angleze (TOEFL, IELTS ose APTIS) në nivelin B1 dhe mesataren mbi 6.5.</li> <li>2. Institucioni ofron informacion rreth programit të studimit që në momentin e regjistrimit.</li> </ol>	

3. Studentët vlerësojnë pedagogun në përfundim të çdo lënde.
4. Institucioni ka të dhëna për performancën akademike të studentëve si dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të diplomuarve.
5. Institucioni ofron këshillim karriere për studentët si dhe i asiston ata në gjetjen dhe kryerjen e internshpit.

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Veprimtaria kërkimore - shkencore e institucionit organizohet dhe zhvillohet në përputhje me ligjin, Statutin dhe Strategjinë e Institucionit. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, nëpërmjet Qendrës Kërkimore për Shkencat Sociale, koordinon edhe aktivitetet kërkimore të njësisë. Qendra ka fituar 3 projekte Erasmus+ në 2 vitet e fundit, me një periudhë kohëzgjatje tre vjeçare. Dy *Jean Monnet Module* (ofimin e lëndëve në lidhje me Integrimin Evropian) dhe një *Jean Monnet Network* për shkëmbimin e praktikave të mira dhe të përvojave të studentëve dhe stafit akademik me universitetet partnere të konsorciumit (Universiteti i Forlisë, Beogradit, Sarajevës dhe Dubrovnikut). Institucioni ka organizuar 3 konferenca shkencore ndërkombëtare. Institucioni nëpërmjet UNYT Press boton periodikisht revistën *Global Outlook* Revistë për Çështjeve Ndërkombëtare dhe Zhvillim Ndërkombëtar.

Pedagogët e këtij programi kanë kryer punime kërkimore dhe studimore të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe kanë publikuar monografi apo artikuj në revista shkencore. Vitet e fundit, ka pasur bashkëpunime të rëndësishëm midis pedagogëve në hulumtime dhe botime të përbashkëta, dhe kjo frymë bashkëpunimi duhet të inkurajohet më tej.

***Gjithsesi, pavarësisht përkushtimit në kërkimin shkencor, në nivel institucional nuk ka një fond specifik minimal për të mbështetur departamentin apo edhe pedagogët për aktivitetet kërkimore shkencore, arritjeve të tyre në projekte ndërkombëtare, apo kumtesave në konferenca të rëndësishme ndërkombëtare dhe botimeve në revista shkencore me faktor impakti.***

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	112
Numri i projekteve kërkimore të fituara	18
Numri i projekteve të zbatuara	3
Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	3
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	290
Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	3
Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	27
Numri i Çmimeve Kombëtare	0

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Institucioni ka zhvilluar programet dhe modulet e veta në bashkëpunim me State University of New York / Empire State College (SUNY – ESC) në Shtetet e Bashkuara, dhe ofron diplomë të dyfishtë për të gjithë studentët që preferojnë dhe aplikojnë veçmas edhe në zyrën e përhershme të Empire State College/State University of New York dhe kanë mundësinë të pajisen krahas diplomës së UNYT, edhe me atë amerikane. Institucioni ka një strategji Ndërkombëtarizimi (2016-2022) e cila synon bashkëpunimin dhe krijimin e rrjeteve me Universitete partnere ndërkombëtare, mobilitetin e studentëve dhe stafit, pjesëmarrjen e administrative në trajnime ndërkombëtare. Për më tepër, UNYT ka nënshkruar Memorandume dhe ka krijuar programe shkëmbimi në disa drejtime, duke përfshirë Shkencat Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare me Science Po, Rennes, në Francë dhe METU në Ankara, Turqi. Disa nga studentët kryejnë studimet në këto universitete për një semestër ose më gjatë, me mundësinë e transferimit të krediteve të tyre kur të kthehen, si dhe anasjelltas, studentët francezë dhe turq që e njohin anglishten akademike mund të kryejnë një semestër në UNYT dhe të transferojnë kreditet e përfitura në universitetin e tyre. Memorandume bashkëpunimi janë nënshkruar edhe me disa universitete ndërkombëtare që përfshijnë shkëmbimin e stafit akademik dhe kërkues shkencor. UNYT është gjithashtu pjesë e rrjetit të universiteteve jo-publike në Shqipëri që përfshijnë UET, Luarasi, UMB, Polis, Marubi etj. UNYT ka nënshkruar disa memorandume mirëkuptimi dhe marrëveshje të tjera partneriteti me disa institucione publike (p.sh. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritetit Evropian etj.) dhe në sektorin privat (p.sh. Balfin, Bolvoil, Agna Group etj.), si dhe organizimin nga institucioni i panairit të punësimit të cilat ju ofrojnë studentëve mundësinë e kryerjes së praktikave, por edhe perspektivën për tu punësuar në të ardhmen pas përfundimit të studimeve.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	21
Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore)	2
Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	6
Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	31
Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	1
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	80
Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor	0

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

Bashkëpunimi me institucionet e tjera konsiston në veprimtari të përbashkëta shkencore, projekte, shkëmbim stafi e studentesh, si dhe praktikë mësimore dhe profesionale të studenteve.

**Memorandum bashkëpunimi:** 2 Institucione Qeveritare, 17 Universitete Ndërkombëtare, 3 universitetet kombëtare, 1 shtëpi botuese, 2 biznese

**Marrëveshje ndër-institucionale Erasmus+ Programme:** 3 Universitete Ndërkombëtare



**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Institucioni ka zhvilluar programin e studimit në bashkëpunim me State University of New York / Empire State College (SUNY – ESC) në Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu, Institucioni ka zhvilluar disa lëndë të modulit Jean Monnet si dhe programi ka përfituar nga shkëmbimet e pedagogëve në universitetet e tjera nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve në programin Erasmus+.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera partnere janë në rank institucional, ku njësitë kryesore dhe ato bazë kanë detyra të mirëpërcaktuara, për stafin akademik dhe atë kërkimor. Në bazë të detyrave specifike të secilit dhe raportimeve individuale të stafit kryen edhe analiza vjetore për të vlerësuar arritjen në fushën e angazhimit në projekte dhe bashkëpunime me të tretët. Institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit dhe me institucione të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka garantuar bashkëpunimin me 2 Institucione Qeveritare, 17 Universitete Ndërkombëtare, 3 universitetet kombëtare, 1 shtëpi botuese, 2 biznese, si dhe ka marrëveshje ndër-institucionale Erasmus+ Programme me 3 Universitete Ndërkombëtare të cilat i vijnë në ndihmë për realizimin e praktikave/intershipet, si dhe shkëmbimin e eksperiencave të studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Institucioni nuk është i licencuar dhe nuk ofron organizimin e trajnime specifike profesionale</p> <p>Institucioni nuk përpilon një raport specifik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale për realizimin e programeve studimore, kjo edhe referuar raportit vjetor të departamentit.</p>
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni bashkëpunon me State University of New York / Empire State College (SUNY – ESC) në Shtetet e Bashkuara, me universitete të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe institucione publike dhe private</li> <li>2. Institucioni nxit bashkëpunimin midis personelit brenda institucionit dhe me institucione të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta.</li> <li>3. Institucioni nuk ofron organizimin e trajnime specifike profesionale dhe nuk ka një analizë të</li> </ol>	

## **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se institucioni i ka plotësuar në tërësi të katër rekomandimet e lëna nga Këshilli i Akreditimit.

IAL-ja ka pasuruar më shumë kurrikulën me kulturë të përgjithshme, me lëndë të formimit bazë dhe të formimit të përgjithshëm të disiplinave të ofruara nga departamente dhe programe të tjera studimi. Gjithashtu, në kurrikul janë përfshirë lëndë që trajtojnë më shumë tema dhe çështje të diplomacisë ekonomike dhe asaj kulturore. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike dhe jo-publike për kryerjen e praktikës nga studentët, me të cilat janë kryer studime dhe punime me interes reciprok për të dy institucionet. Studentët e diplomuar janë kryesisht të punësuar në përputhje me diplomën, në institucione në administratën publike, organizata ndërkombëtare apo OJF.

Megjithatë, vlerësojmë se institucioni duhet të adresojë disa çështje të tjera me qëllim përmirësimin e programit të studimit. Rekomandojmë që departamenti:

1. të konsiderojë angazhimin e pedagogëve të tjerë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, e cila do të lehtësojë ngarkesën e madhe të disa pedagogëve si në numër orësh por edhe në numër lëndësh që ata mbulojnë, kjo do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së programit të studimit.
2. të rishikojë shpërndarjen e lëndëve të planit mësimor sipas veprimtarive formuese (A-F) duke respektuar përqindjen totale të lëndëve sipas kategorive dhe për më tepër të ndjekë një logjikë të qartë të ndarjes së lëndëve në kategoritë respektive, si dhe të standartizojë paraqitjen formale të prezantimit të syllabuseve dhe përditësimin e tyre.
3. të kryejë një studim tregu, bazuar mbi dokumentin Startegjik të Politikës së Studimit të Tregut dhe të përshtatur posaçërisht për programin e studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.



## II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

### a. Pika të forta:

- 1) Kurrikul bashkëkohore që ndërthur ofrimin e njohurive të përgjithshme bazë me specializimin e studentëve në debatet më të rëndësishme, veçanërisht ato që janë relevante për shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.
- 2) Angazhimi i një stafi pedagogësh të kualifikuar, të specializuar kryesisht jashtë vendit dhe përmes kërkimit shkencor, garanton përmbushjen me cilësi të qëllimeve të programit të studimit.
- 3) Bashkëpunimi me institucione akademike homologe për realizimin e mobilitetit të studentëve rrit ndërkombtarizimin e institucionit si dhe shkëmbimin e praktikave të mira.
- 4) Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare që mbështesin kërkimin shkencor, dhe mobilitetin e stafit akademik kontribuojnë në rritjen e cilësisë të përgjithshme të punës shkencore.
- 5) Përdorimi i sistemit anti-plagjiaturë TURNITIN-in, mundëson kontrollin për nivelin e origjinalitetit të detyrave dhe punimeve të studentëve.
- 6) Aksesi në bibliotekën elektronike Ebrary të universitetit partner American (University SUNY Empire State College), si dhe në bazat e të dhënave të bibliotekave online si JSTOR, QUESTIA, EBSCO dhe së fundmi në bibliotekën elektronike të librave të McGraw Hill, ofron materiale didaktike cilësore për realizimin e programit të studimit

### b. Pika të dobëta:

- 1) Numri i vogël i pedagogëve të angazhuar në lëndët e specializimit shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare (për periudhën 2013-2019 numri i pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në lëndë të specializimit në shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare varion nga 5 deri në 6, përveç vitit akademik 2017-2018 ku kanë qënë të angazhuar 9 pedagogë) si dhe ngarkesa e tyre e lartë (shumica e pedagogëve mbulojnë 6 apo më tepër lëndë të cilat janë me 6 ose 8 ECTS, p.sh përgjegjësi i departamentit ka 8 lëndë në këtë program studimi ose 58 ECTS e cila korrespondon me rreth 23% të ngarkesës totale të programit të studimit Bachelor Shkencë Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare, pa konsideruar pa përfshirë angazhimet e tyre në detyrat e tjera administrative dhe punën shkencore kërkimore që stafi akademik mbulon).
- 2) Shpërndarja e lëndëve të planit mësimor sipas veprimtarive formuese dhe standardizimi i paraqitjes formale të prezantimit të syllabuseve dhe përditësimi i tyre. Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F), nuk i respekton përqindjen totale të lëndëve sipas kategorive dhe për më tepër nuk ndjek një logjikë të qartë të ndarjes së lëndëve në kategorinë respektive, p.sh lëndët karakterizuese të tipit B përbëjnë 39% (100/256) të programit, jo rreth 50% - 55%; lëndët *Classics of Political Thought* apo *US History II/American Government and Politics* janë klasifikuar si Lëndë Bazë të kulturës së përgjithshme të tipit A, jo lëndë karakterizuese të tipit B të përgatitjes për disiplinën shkencore; ndërkohë lëndët *Statistics I, Social Science Research* janë klasifikuar si lëndë të tipit B (karakterizuese, të përgatitjes për disiplinën shkencore) dhe jo tipi A (Lëndë Bazë të përgatitjes metodologjike). Për sa i përket syllabuseve në radhë të parë, nga ana e formës, formati nuk është standard dhe i uniformuar për të gjitha lëndët, nga pikëpamja e strukturës dhe organizimit të seksioneve të ndryshme të syllabusit. Së dyti, nga pikëpamja e përmbajtjes, janë disa lëndë që prezantohen me listë librash dhe leximesh të papërditësuara. Në disa raste, librat e sugjeruara ndaj studentëve janë të tejkaluar dhe nuk mbulojnë zhvillime të rëndësishme të fushës.
- 3) Mungesa e studim tregu të përshtatur posaçërisht për programin e studimit BSc në Shkencë Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.

**c. Mundësitë:**


- 1) Emri dhe imazhi pozitiv që ka krijuar institucioni ndihmon për të tërhequr pedagogë të kualifikuar, për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me universitetete të tjera si dhe për të tërhequr studentë sa më cilësorë.
- 2) Zhvillimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare në funksion të programit të studimit, veçanërisht e dobishme për studentët.
- 3) Përfshirja në programe dhe projekte të ndryshme kërkimore si dhe bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë rrisin mundësinë e kualifikimit të stafit dhe për kryerjen e praktikës studentore.
- 4) Krijimi i një rrjeti të mirë midis institucioneve dhe organizatave, si edhe studentëve alumni, do të ndihmonte të diplomuarit për tu integruar më të mirë në tregun e punës.
- 5) Programi i studimit është në linjë me proceset dhe politikat strategjike të zhvillimit të vendit dhe i përshtatet nevojës së tregut për ekspertë në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare

**d. Pengesat:**

- 1) Konkurenca me programe studimi më tërheqëse sjell edhe një interes më të ulët të studentëve në këtë fushë
- 2) Vështirësi në diversifikimin e burimeve financiare reflektohet në koston e lartë të studimit

**e. Rekomandime**

- 1) Të konsiderojë angazhimin e pedagogëve të tjerë me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, e cila do të lehtësojë ngarkesën e madhe të disa pedagogëve si në numër orësh por edhe në numër lëndësh që ata mbulojnë, kjo do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së programit të studimit.
- 2) Të rishikojë shpërndarjen e lëndëve të planit mësimor sipas veprimtarive formuese (A-F) duke respektuar përqindjen totale të lëndëve sipas kategorive dhe për më tepër të ndjekë një logjikë të qartë të ndarjes së lëndëve në kategoritë respektive, si dhe të standartizojë paraqitjen formale të prezantimit të syllabuseve dhe përditësimin e tyre.
- 3) Të kryejë një studim tregu, bazuar mbi dokumentin Startegjik të Politikës së Studimit të Tregut dhe të përshtatur posaçërisht për programin e studimit BSc në Shkenca Politike / Marrëdhënie Ndërkombëtare.



## **SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM**

### **1. SUMMARY ANALYSIS OF IMPLEMENTATION OF RECOMMENDATION FROM THE FIRST ACCREDITATION**

The External Evaluation Group notice that the institution has fully met the four recommendations left by the Accreditation Council.

The HEI has enriched the curriculum with more basic courses and course of other disciplines provided by other departments and study programs. Also, within the curriculum there have been included subjects that deal with topics and issues of economic and cultural diplomacy. The institution has signed agreements with public and non-public institutions for conducting internships for students, whereas studies and research of mutual interest for both institutions have been undertaken. The graduated students are mainly employed in accordance with their academic background in public administration institutions, international organizations or NGOs.

However, we judge that the institution should address some other issues in order to improve the study program. We recommend that the department:

- 1) considers the engagement of other full time or part-time professors, which would facilitate the great workload of some other professors with regards to the number of teaching hours but also to the number of the courses they teach, this will contribute to the quality of the study program;
- 2) review the allocation of the modules of the curriculum according to the forms of activity (A-F) by respecting the total percentage of subjects by each category and moreover pursuing a clear logic of the division of subjects into the respective categories,, as well as standardize the formal presentation of syllabus and their updating literature;
- 3) Conduct a market research based on the Market Research Policy Paper and tailor it specifically to the BSc study program in Political Science / International Relations;

### **2. SWOT ANALYSIS (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

#### **a. Strengths**

- 1) Contemporary curriculum combining provision of basic knowledge and specialization of students in the most important debates, particularly those relevant to political science and international relations
- 2) The engagement of qualified pedagogue staff, specializing mainly abroad and through scientific research, guarantees the quality performance of the study program goals
- 3) Cooperation with homologous academic institutions for the realization of student mobility increases the internationalization of the institution and the exchange of good practices
- 4) Participation in international projects that support scientific research, and the mobility of academic staff contribute to the increase of the overall quality of scientific work
- 5) The use of the TURNITIN anti-plagiarism system enables control of the level of originality of the tasks and work of the students
- 6) Access to the Ebrary electronic library of the American University (SUNY Empire State College), as well as online libraries such as JSTOR, QUESTIA, EBSCO and recently in McGraw Hill's electronic library, provides qualitative didactic material for the realization of the study program



**b. Weak points:**

- 1) There is a small number of pedagogues engaged in subjects of specialization in political science and international relations (for the period 2013-2019 the number of full-time as well as part-time professors for the subjects in political science and international relations varies from 5 to 6, with the exception of the academic year 2017-2018 where there has been engaged 9 pedagogues) as well as they have a high workload (most of the pedagogues cover 6 or more subjects each of them with 6 or 8 ECTS, e.x. the head of the departament teaches 8 courses in this study program or 58 ECTS which corresponds to about 23% of the total workload of the Bachelor study program in Political Science / International Relations, this without taking into consideration their engagements in other administrative duties and their scientific research workload)
- 2) Distribution of syllabus subjects by their formative activities and the standardization of formal presentation of syllabi presentation and their updating (The curriculum set-up by its Formative Activities (A-F) does not respect the total percentage of distribution of subjects by categories and moreover it does not follows a clear logic of their distribution into the respective category, i.e. B type characterizing subjects constitute 39% ( 100/256) of the program, not about 50% - 55%; the courses *Classics of Political Thought or US History II / American Government and Politics* are classified as general courses of Type A, not B-type of subjects for the scientific discipline; Meanwhile, *Statistics I, Social Science Research subjects* are classified as B-type (subjects of the preparation scientific discipline) and not Type A (Basic Methodological Course Materials). With regard to the Syllabus, the format is not standard and uniform for all courses, from the point of view of the structure and organization of different sections of the syllabus; secondly, from the point of view of their content, there are some courses that include not up-to-date list of books and study materials, some of the literature suggested is outdated and do not cover important developments in the field.
- 3) Lack of a market research tailored specifically to the BSc study program in Political Sciences / International Relations

**c. Opportunities:**

- 1) The brand and positive image that the institution has created helps to attract qualified pedagogues, to establish cooperative relationships with other universities and to attract more qualified students
- 2) The development of extracurricular activities for the purpose of the study program, will be particularly useful for students
- 3) The involvement in various research programs and projects and the cooperation with other higher education institutions increases the ability of the staff to further qualify and of the students to conduct their internships
- 4) Creating a good network between institutions and organizations, as well as alumni students, would help graduates to better integrate into the labor market
- 5) The study program is in line with the country's strategic development processes and policies and it fits the market needs for experts in political science and international relations

**d. Threats:**

- 1) Competition with more attractive study programs also brings a lower interest of students in this field
- 2) Difficulties in diversifying financial resources are reflected in a higher study costs.



**e. Recommendations**

- 4) Considers the engagement of other full time or part-time professors, which would facilitate the great workload of some other professors with regards to the number of teaching hours but also to the number of the courses they teach, this will contribute to the quality of the study program;
- 5) Review the allocation of the modules of the curriculum according to the forms of activity (A-F) by respecting the total percentage of subjects by each category and moreover pursuing a clear logic of the division of subjects into the respective categories,, as well as standardize the formal presentation of syllabus and their updating literature.
- 6) Conduct a market research based on the Market Research Policy Paper and tailor it specifically to the BSc study program in Political Science / International Relations;

**External Evaluation Group**

PhD. Dorian Jano

PhD. Gentian Elezi

